

L I G J
Nr.9585, datë 17.7.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR PROCEDURAT TATIMORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Fondet për administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe degëve të saj në rrethe sigurohen nga Buxheti i Shtetit. Përfundimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime e shpenzime operative, është sipas ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5005, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**